



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 768 Akti

Nr. 660 Vendimi
Tiranë, më 16.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Alma Faskaj	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datën 15.5.2023, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Majlinda Andrea**, ish-gjyqtare e Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, ushtronte detyrën e anëtares së Gjykatës së Lartë e, për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, është emëruar në detyrën e anëtares së Gjykatës së Lartë me Dekretin Nr. ***, datë 8.7.2008, të Presidentit të Republikës.
3. Me vendimin nr. ***, datë 7.3.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për herë të parë ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit. Në mbledhjen e Komisionit, datë 7.3.2018, në rregulloren e shortit të Komisionit u shtua një pikë, e cila parashikon se: *“Në rast të dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit, të cilët nuk janë shortuar ende në përputhje me këtë rregullore, shqyrtimi i kërkesës do të bëhet nga një trup gjykues i përzgjedhur me short për një periudhë njëvjeçare”*.
4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. ***, datë 14.12.2021, vendosi që në tekstin e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, të shtohen në pikën 11, reshti i tretë, pas togfjalëshit *“kanë mbushur moshën për pension”* togfjalëshat *“ndërruar jetë/janë dënuar me vendim gjyqate të formës së prerë”*.
5. Me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.***, datë 11.2.2021, “Për ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit”, u vendos ngritja e trupit gjykues, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Suela Zhegu dhe Firdes Shuli.
6. Me vendimin nr.***, datë 4.4.2022, Komisioni vendosi zgjatjen e afatit të veprimtarisë së trupit gjykues, të ngritur me vendimin nr. ***, datë 11.2.2021, deri në përfundimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit Majlinda Andrea. Trupi gjykues i gatshëm caktoi me mirëkuptim si relatore komisioneren Alma Faskaj, si dhe ka deklaruar mospasjen e konfliktit të interesit nga anëtarët e tij.
7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike me *email*, mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 26.1.2022 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej

në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Subjekti njoftoi gjithashtu se kishte caktuar si përfaqësuese ligjore av. Antoneta Sevdari për ta përfaqësuar para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe depozitoi prokurën e posaçme nr. ***, datë 26.1.2022.

8. Subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, ka qenë subjekt i ligjit në momentin e hyrjes në fuqi të tij. Me vendimin nr. ***, datë 14.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ajo është dënuar për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe në zbatim të nenit 319/Ç të Kodit Penal është dënuar me 4 vjet burg. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prove prej 3 vjetësh, si dhe në zbatim të nenit 35/1 të Kodit Penal i është caktuar si dënim plotësues heqja e të drejtës për të kryer funksione publike për një aftat prej 5 vjetësh.

9. Sipas neneve 23 dhe 24 të Kodit të Procedurës Administrative, vijimi i procesit për subjektin e rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, u vlerësua jashtë kompetencës së trupave të gatshme që janë ngritur me vendim të Komisionit, që në vitin 2018 dhe në vijim, për arsye se:

- Me vendimin nr. ***, datë 7.3.2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për herë të parë *ngritjen e trupit gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit*. Ky vendim u mor pas diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e Komisionit të datës 7.3.2018, ku u vendos që në rregulloren e shortit të Komisionit të shtohet një pikë, ku të parashikohet se: *“Në rast të dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit, të cilët nuk janë shortuar ende në përputhje me këtë rregullore, shqyrtimi i kërkesës do të bëhet nga një trup gjykues i përzgjedhur me short për një periudhë njëvjeçare”*.
- Komisioni çmoi se nuk gjendet para një rasti dorëheqjeje nga detyra, në kuptim të nenit 56 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit; 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfutojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1 e ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*”.

10. Me vendimin nr. ***, datë 7.4.2023, të Komisionit u ngrit trupi gjykues për të zhvilluar procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, i përberë nga komisionerët Alma Faskaj, Fides Shuli dhe Olsi Komici.

11. Subjekti u njoftua në rrugë elektronike për përbërjen e këtij trupi, por nuk deklaroi as pasjen ose mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

12. Në datën 8.5.2023, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

13. Po në të njëjtën datë, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë brenda datës 12.5.2023, ora 13:00.

14. Subjekti i rivlerësimit dhe as përfaqësuesja e saj nuk u njohën me materialet e dosjes.

15. Në datën 15.5.2023, përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit dërgoi shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

16. Në datën 12.5.2023, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Majlinda Andrea në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 15.5.2023, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), Tiranë.

17. Në datën 15.5.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, ku as subjekti i rivlerësimit dhe as përfaqësuesja e saj ligjore, znj. Antoneta Sevdari, nuk ishin të pranishme.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Majlinda Andrea ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke iu përgjigjur *emaile*-ve të dërguara nga Komisioni, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

24. Por, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

Hetimi i zhvilluar nga Komisioni

26. Me fillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Lartë¹ për të vënë në dispozicion vendimin, sipas të cilit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata e Lartë² ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurës Majlinda Andrea për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe në zbatim të nenit 319/ç të Kodit Penal dënimin e saj me 4 vjet burgim.*
- *Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prove prej 3 vjetësh. Urdhërohet e dënuara Majlinda Andrea që të mbajë kontakte me shërbimin e provës në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në zbatim të nenit 35/1 të Kodit Penal të caktohet si dënim plotësues, heqja e të drejtës për të kryer funksione publike për një afat prej 5 vjetësh.*

27. Në vijim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë 24.4.2018³, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës me objekt “shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. ***, datë 14.6.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë””.

28. Komisioni iu drejtua Këshillit të Lartë Gjyqësor⁴, i cili informon se nuk rezulton asnjë vendimmarrje lidhur me mbarimin e statusit të magjistratit për këtë subjekt. Bazuar në të dhënat që disponon, Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se ish-kryetari i Gjykatës së Lartë i është drejtuar Presidentit të Republikës dhe Ministrisë së Drejtësisë, si dhe ka

¹ Në përmbajtje të vendimit sa më sipër, Komisioni konstatoi se znj. Majlinda Andrea gjatë gjykimit është gjykuar pa masë sigurimi personal. Konstatohet gjithashtu se Prokuroria e Përgjithshme ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën për gjykim për të pandehurit, për të cilët kishte regjistruar procedimin penal, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit në datën 14.10.2016.

² Shkresë nr. *** prot., datë 11.1.2022, e Gjykatës së Lartë.

³ Shihni www.gjykatakushtetuese.gov.al

⁴ Shkresat nga KLGJ-ja: kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2022; dhe nr. *** prot., datë 18.1.2022.

kërkuar fillimin e procedurave për deklarimin e përfundimit të mandatit të gjyqtarës së Gjykatës së Lartë, znj. Majlinda Andrea. Kjo kërkesë i kaloi për kompetencë trajtimi ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky i fundit, në mbledhjen plenare të datës 17.7.2017, pas diskutimeve përkatëse ka vendosur mbi mosmiratimin e kërkesës së ish-kryetarit të Gjykatës së Lartë, si dhe është propozuar nga ky organ që kërkesa t'i kalojë për shqyrtim Presidentit të Republikës.

29. Institucioni i Presidentit të Republikës⁵ informon se nga verifikimi arkivor i administruar rezulton se korrespondenca e fundit që lidhet me çështjen e subjektit daton 3.8.2017 dhe, për pasojë, nuk ka asnjë vendimmarrje nga ana e këtij organi.

30. Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon se deri në datën 21.1.2022 nuk rezulton të ketë nisur hetim disiplinor dhe nuk ka paraqitur kërkesë për procedim disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për marrjen e masës “shkarkim nga detyra” ndaj magjstrates Majlinda Andrea.

31. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi referuar rrethanave të çështjes dhe dokumentacionit të administruar rezulton e provuar se subjekti në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre akteve ka qenë e pezulluar nga detyra e gjyqtarës së Gjykatës së Lartë, për shkak të procedimit penal që po zhvillohej ndaj saj. Pra, pezullimi i saj, për shkak të një procesi penal të filluar, nuk e përjashton atë nga qenia subjekt i ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, për Komisionin qëndron detyrimi i kryerjes së procesit dhe rivlerësimit të saj konform kuadrit ligjor në fuqi.

32. Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, është marrë si e pandehur me kërkesën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, datë 14.10.2016.

33. Znj. Majlinda Andrea, me vendimin penal nr. ***, datë 14.6.2017, të Kolegjit të Gjykatës së Lartë, është deklaruar fajtorë për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe në zbatim të nenit 319/ç të Kodit Penal është dënuar me 4 vjet burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për një afat prove prej 3 vjetësh. Urdhërohet e dënuara Majlinda Andrea që të mbajë kontakte me shërbimin e provës në bazë të nenit 60 të Kodit Penal. Në zbatim të nenit 35/1 të Kodit Penal të caktohet si dënim plotësues, heqja e të drejtës për të kryer funksione publike për një afat prej 5 vjetësh.

34. Trupi gjykues, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit rezulton i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në mungesë të një vendimi të organeve

⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.4.2022, nga Institucioni i Presidentit të Republikës.

kompetente të kohës, ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe atyre sot, Këshilli i Lartë Gjyqësor, çmon se duhet të kryejë procesin e rivlerësimit.

35. Trupi gjykues i kaloi subjektit barrën e provës se në analizë të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili e ka dënuar atë për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, subjekti ka cenuar rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

36. Subjekti paraqiti para Komisionit parashtrimet e saj, ndër të tjera, se Komisioni, në rastin konkret, nuk ka kompetencë të kryejë procesin e rivlerësimit ndaj saj dhe për këtë arsye ndërhyrja është e paparashikuar në ligj. Në vijim, subjekti parashtron se Komisioni duhet të vendosë për procesin e saj, mbështetur në trajtimin e statusit të subjektit, dhe përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, pa një vendim përfundimtar bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurës Administrative si zgjidhjen e duhur dhe të drejtë ligjore.

Vlerësimi i Komisionit

37. Komisioni, në vlerësim të situatës ligjore e faktike, në përputhje me nenin 104 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e magjistratit në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: *“Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë: a) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, për të cilat ligji parashikon dënim me burgim ose me gjobë; b) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është deklaruar fajtor dhe dënua me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia; c) faktet e pranuar nga gjykata, për të cilat magjistrati është dënua nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni, nëse për vetë natyrën e faktit penal të konsumuar është diskredituar rëndë figura, autoriteti, dinjiteti, si dhe është dëmtuar rëndë besimi i publikut”* – duke qenë se subjekti është dënua për kryerjen e një vepre penale të rëndë, vlerëson se gjendet në kushtet e cenimit të rëndë të besimit të publikut, në këndvështrim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, duhet të marrë masën e shkarkimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se në zbatim të nenit 61 “Shkarkimi nga detyra” pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Majlinda Andrea, ish-gjyqtare e Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 16.5.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Alma FASKAJ
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka